

VENDIM
Nr. 296, datë 18.11.2022

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 93, DATË 28.4.2022 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ECO-ELB’ SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI I PËRPUNIMIT TË MBETJEVE URBANE, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2850 kw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1948/1 prot., datë 10.11.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.4.2022 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘ECO – ELB’ sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kw”.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 93, datë 28.4.2022, vendosi të licencojë shoqërinë “ECO – ELB” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali prodhues i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kw, deri në datën 27.3.2023. Brenda datës 1.7.2022, shoqëria duhet të depozitonte në ERE dokumentet/qëndrimin përkatës të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në lidhje me transferimin e lejeve.

- Me shkresën nr. 560/5 prot., datë 5.5.2022, ERE i njoftoi shoqërisë vendimin nr. 93/2022.

- Brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të vendimit nr. 93/2022, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 560/6 prot., datë 23.6.2022, shoqëria ka bërë me dije se në vijim të kërkesës së saj të depozituar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), me urdhrin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 177, datë 6.6.2022, ka përfunduar transferimi i lejes mjedisore të tipit A, me PN-5783-09-2017.

- Po ashtu, ka bërë me dije se për sa i përket transferimit të lejes mjedisore të tipit A “Lendfilli i mbetjeve (D1), duke përjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte”, ka pasur komunikime të vazhdueshme me AKM-në dhe kjo leje është në proces transferimi.

- Në vijim, ERE i është drejtuar AKM-së me shkresën nr. 560/8 prot., datë 28.7.2022 dhe nëpërmjet postës elektronike imeilin e datës 14.9.2022 dhe shkresën nr. 560/11 prot., datë 18.10.2022, duke kërkuar informacionin/sqarimin përkatës nëse kjo leje lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga subjekti “ECO – ELB” sh.a., apo ushtrimi i veprimtarisë përkatëse për të cilën është dhënë kjo leje është i ndarë nga veprimtaria e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 27.10.2022, AKM-ja ka informuar ERE-n se leja e mjedisit të tipit A, e subjektit “ECO – ELB” sh.a., për veprimtarinë “Lendfilli i mbetjeve (D1), duke përjashtuar lendfillimin e mbetjeve inerte, është e ndarë nga veprimtaria e prodhimit të energjisë elektrike.

- Për sa më sipër, pikat 2 dhe 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 93, datë 26.4.2022, duhet të shfuqizohen.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti administrativ, me nismën e vetë organit, që ka nxjerrë aktin, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.4.2022, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT
Maksim Shuli